

## NDIHMA JURIDIKE PA PAGESË NË PROCEDURËN E SHKURORËZIMIT

Arta SELMANI\*

**Abstrakt:** Shkurorëzimi është institucion i të drejtës familjare i cili mundëson zgjidhjen e martesës së plotfuqishme. Shkaqet janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga shkurorëzimet që bëhen me marrëveshje të bashkëshortëve, shkurorëzimet fiktive, si dhe shkurorëzimet si alternativë e vetme e shërimit të marrëdhënieve të çrregulluara bashkëshortore. Mirëpo, procedurat e shkurorëzimit ngarkojnë palët materialisht, dhe si rezultat i kësaj disa bashkëshortë pengohen në zgjidhjen e martesës veçanërisht në situatat kur ndarja është e patjetërsueshme. Për tejkalimin e këtyre vështirësive materiale për të iniciuar dhe zhvilluar procedurën gjyqësore të shkurorëzimit, institucioni i ndihmës juridike falas luan një rol të veçantë. Prandaj, në këtë punim do të paraqesim:

- rëndësinë dhe rolin e ndihmës juridike pro-bono në procedurën e shkurorëzimit-ofrimit të shërbimit juridik falas nga ana e avokatit i cili do të mbrojë interesin e palës në gjykim për zgjidhjen e martesës në situatën kur marrëdhëniet bashkëshortore janë të vështirësuar deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është e padurueshme por edhe në situatat kur për shkurorëzimin ekziston marrëveshja e bashkëshortëve,
- pasojat juridike të shkurorëzimit ndaj ish-bashkëshortëve dhe për fëmijët,
- mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve të cilët mbartin pasojat e kësaj pjese të padëshirueshme të jetës së tyre- ndarjen e prindërve.

Në shtetin tonë ofrimi i ndihmës juridike pa pagesë është një institucion i ri i cili fare pak ose aspak nuk gjen shprehje në praktikën gjyqësore, veçanërisht në sferën e kontesteve familjare: zgjidhja e martesës, dhënia e alimentacionit fëmijëve dhe bashkëshortit të pasiguruar materialisht, zgjidhja e kontesteve lidhur me ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve, zgjidhja e kontesteve lidhur me vërtetimin ose kundërshtimin e atësinë ose amësinë etj.

Shërbimet pa pagesë për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim në të shumtën e rasteve jepen nga ana e organizatave joqeveritare të cilët promovojnë dhënien e ndihmës juridike falas në formë të këshillimeve nëpërmjet telefonit, postës elektronike, dhe në raste shumë të rralla edhe përfaqësime në gjyq nga ana e avokatëve të angazhuar nga OJQ.

Republika e Maqedonisë nuk ka në fuqi ligj për ndihmën juridike pa pagesë, mirëpo në Kuvendin e RM-së diskutohet rreth propozim ligjit për këtë lloj të ndihmës juridike i cili duhet të miratohet sepse ka një rëndësi të konsiderueshme për funksionimin e sistemit të së drejtës edhe për personat të cilët kanë nevojë për ndihmë dhe këshillime juridike, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar këto shërbime. Rol të patjetërsueshëm për realizimin e këtyre reformave të profesionit ligjorë ka edhe Oda e avokatëve të RM-së, e cila duhet të ketë listë të posaçme të avokatëve të cilët do të paraqiten si mbrojtës i palës kërkuese të kësaj ndihme.

**Fjalët çelës:** zgjidhja e martesës me shkurorëzim, shkaqet për shkurorëzim, ndihma juridike pa pagesë, pasojat juridike të shkurorëzimit, mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve prindërit e të cilëve shkurorëzohen.

## 1. Hyrje

Martesa është institucion i rëndësishëm i së drejtës familjare, dhe paraqet marrëdhënie të jetës së përbashkët e të vazhdueshme midis një burri dhe një gruaje, ndërkaq në disa shtete edhe marrëdhënie midis dy personave me gjini të njëjtë (në shtete të cilët kanë të legalizuar martesën midis personave me gjini të njëjtë). Të gjitha legjislacionet nacionale japin definicionin e institucionit të martesës- Martesa është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas e rregulluar me ligj në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Marrëdhëniet në mes bashkëshortëve themelohen në vendim të lirë të burrit dhe gruas për të lidhur martesë, në barazinë ndërmjet tyre, respektim të ndërsjellët dhe ndihmës reciproke (neni 6 i Ligjit mbi familjen të RM-së Gazeta Zyrtare e RM-së nr.157/2008, në tekstin e mëposhtëm LF). Barazia e bashkëshortëve si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi garantohet edhe me dokumentin më të rëndësishëm ndërkombëtarë- Deklaratën Universale të të drejtave të njeriut (neni 16.al.1). Siç e cekta edhe më lart, martesa është marrëdhënie e vazhdueshme por jo e përhershme sepse e njëjta mund edhe të zgjidhet me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e njërit nga bashkëshortët e zhdukur për të vdekur, me anulimin e martesës dhe me shkurorëzimin e saj.

Në këtë punim do të bazohemi vetëm në ndarjen e martesës me anë të institucionit të shkurorëzimit, duke u fokusuar në ndihmën juridike pa pagesë e cila duhet ti garantohet dhe ofrohet palës me gjendje më të dobët financiare e cila ka qëllim ndarjen nga martesa vazhdimi i së cilës është bërë i padurueshëm. Pra, personat të cilët do të dëshmojnë gjendjen e vështirë ekonomike duhet të ju mundësohet qasje efektive në drejtësi për të realizuar të drejtat e tyre të garantuara.

## 2. Shkurorëzimi

Mbi të gjitha parakushtet tjera, martesa duhet të bazohet në dashurinë, respektin, barazinë dhe ndihmën reciproke, mirëpo në rast të disekuilibrit dhe mosrespektimit të këtyre parimeve jeta bashkëshortore mund të bëhet e padurueshme për vazhdimin e suksesshëm të saj. Pra, shkurorëzimi është pasojë e mosmarrëveshjeve dhe grindjeve permanente midis partnerëve. Shkurorëzimi është institucion i lashtë, dukuri përbërëse dhe e pandashme e martesës. Volteri thoshte se shkurorëzimi lind disa javë pas martesës. Do të thotë, atëherë kur lind martesa, lind edhe shkurorëzimi.<sup>1</sup> Të tjerët e quajnë si një opsion nuklear në marrëdhëniet martesore.<sup>2</sup> Si institucion i së drejtës familjare dhe pjesë e marrëdhënieve të jo-qëndrueshme martesore, shkurorëzimi daton që nga e drejta romake, mirëpo, të dhënat statistikore japin një pasqyrë të rritjes së numrit të shkurorëzimeve gjatë kësaj periudhe të tranzicionit dhe mvetësimit ekonomik të partnerëve. Betimi ‘deri sa vdekja të na ndajë‘ ka mbetur vetëm shprehje e shënuar në letër, sepse kuptimi i vërtetë ka filluar t’i zbehet.

\* Këshilltare në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Evropës Juglindore, Ilindeska p.n,1200 Tetovë, R. e Maqedonisë. Autorja mirëpret sugjerime dhe komente në adresën: [arta.selmani@seeu.edu.mk](mailto:arta.selmani@seeu.edu.mk).

<sup>1</sup> Gani Oruçi, *E drejta familjare*, Prishtinë, 1994, fq. 89.

<sup>2</sup> *A Few Words About Divorce*, gjendet në : <http://diggerjones.wordpress.com/2006/12/06/a-few-words-about-divorce>.

Në rastet kur jeta e përbashkët tani më nuk është alternativa e vetme për të vazhduar më tej, shumica e bashkëshortëve përgatiten t'i përballen sfidës së jetesës në mënyrë të pavarur dhe të ndarë. E gjitha kjo është pasojë e problemeve të papërballueshme të cilat i përkasin martesës së tyre, duke pasur të drejtën e vendimmarrjes së përbashkët se a do t'i japin asaj fund me anë të institucionit të shkurorëzimit.

Në rastet e marrëveshjes së përbashkët të bashkëshortëve gjykata e cila zhvillon procedurën e shkurorëzimit e ka shumë më lehtë të sjell vendimin për ndarjen e tyre. Mjet juridik për iniciimin e procedurës së shkurorëzimit përveç marrëveshjes (propozimit) së përbashkët të bashkëshortëve<sup>3</sup> është edhe kërkesa e njërit bashkëshort, pra me anë të padisë së ngritur nga ana e njërit bashkëshort. Në pajtueshmëri me nenin 237 të LF- pas pranimit të padisë për shkurorëzim ose propozimit për shkurorëzim me marrëveshje, para dorëzimit të padisë të paditurit mbahet seancë për pajtim të bashkëshortëve.

Seancë për pajtim të bashkëshortëve nuk do mbahet në këto raste:

1. nëse njëri nga bashkëshortët është i paaftë për të gjykuar;
2. nëse njëri ose të dy bashkëshortët jetojnë në botën e jashtme;
3. nëse është i pa njohur vendbanimi i njërit nga bashkëshortëve më tepër se 6 (gjashtë) muaj;
4. nëse pas parashtrimit të kundërpadisë për shkurorëzim, pa marrë parasysh kur është parashtruar, tentimi për pajtim të bashkëshortëve ka qenë i pasuksesshëm.

Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar ushtrimi i të drejtës prindërore, tentimi për pajtim të bashkëshortëve realizohet nga qendra për punë sociale. Në raste nga al.3 e këtij neni gjykata në afat prej 8 (tetë) ditësh njofton me shkrim qendrën për punë sociale lidhur me të dhënat se kur është iniciuar procedura e shkurorëzimit, arsye kryesore pse kërkohet shkurorëzimi dhe të dhënat për fëmijët. Qendra për punë sociale është e obliguar që në afat prej 3 (tre) muajve nga pranimi i njoftimit me shkrim ta përfundoj Seancën për pajtim të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të përbashkët ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar ushtrimi i të drejtës prindërore, procedurën për pajtimin e bashkëshortëve e zhvillon gjykata, por vetëm nëse nuk vlerësohet se është më mirë që procedura për pajtim të zhvillohet nga qendra për punë sociale.

Në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave statistikore nga Enti shtetëror për statistikë, numri i shkurorëzimeve 6-7 viteve të fundit vazhdimisht është në rritje. Në vitin 2003 janë regjistruar kurorëzimi i 14.402 martesave dhe ka pasur 1.405 shkurorëzime; në vitin 2004 – 14.073 kurorëzime dhe 1.645 shkurorëzime; në vitin 2005- 14.500 kurorëzime dhe 1.552 shkurorëzime; në vitin 2006- 14.908 kurorëzime dhe 1.475 shkurorëzime; në vitin 2007-

<sup>3</sup> Martesa mund të shkurorëzohet me pëlqimin reciprok të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët, apo fëmijë madhor të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore, është e nevojshme që të dorëzojnë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të drejtave dhe detyrimeve prindërore dhe për ushqimin dhe edukimin e fëmijëve. Gjykata do të sjell vendim për shkurorëzim pas pëlqimit reciprok të bashkëshortëve nëse vërtetohet se pëlqimi i tyre është i lirë, serioz dhe i vendosur (neni 39 i LF).

15. 490 kurorëzime dhe 1.417 shkurorëzime. Ndërkaq sipas të dhënave të fundit statistikore (16.06.2009) gjatë vitit 2008, kemi zvogëlimin e numrit të kurorëzimeve dhe numrit të shkurorëzimeve. Në krahasim me vitin 2007, lidhja e martesave në vitin 2008 është zvogëluar për 5.1 % d.m.th janë lidhur 14.695 martesa.

Gjatë vitit 2008 më tepër martesa janë lidhur në muajin gusht (13.1%), ndërkaq më pak martesa në muajin prill (4.8%). Moshë mesatare gjatë lidhjes së martesës së parë është 24.7 vjet për femrën dhe 27.7 për mashkullin. Statistikat japin rezultatin se numri i shkurorëzimeve në vitin 2008 (1.209) është 14.7 % më i ulët se në vitin 2007. Sa i përket muajve, më tepër shkurorëzime janë regjistruar në muajin dhjetor (11.4%), më pak në muajin gusht (2.5%).<sup>4</sup>

Paraqitja në mënyrë grafike:



### 3. Shkaqet për Shkurorëzim

Shkurorëzimi (divorci) është një problem sa juridik aq edhe social dhe kryesisht shkaktohet, kur ndërmjet dy partnerëve është thyer ndjenja, intimiteti, komunikimi dhe padyshim që marrëdhënia nuk funksionon më, duke përfshirë në një stres të përgjithshëm tek të gjithë anëtarët. Divorci është një situatë tepër stresuese për të gjithë pjesëtarët e familjet që e përjetojnë atë dhe paraqitet si një ndryshim madhor në jetën e individit, të cilit i nevojitet një kohë e konsiderueshme për t'u rikuperuar e adaptuar me të.<sup>5</sup> Shkurorëzimin e një martese e shkaktojnë shkaqet për të cilët bashkëshortët e vendosin ndarjen e tyre dhe këto shkaqe gjykata i merr për bazë gjatë zhvillimit të procedurës.

<sup>4</sup> Të dhënat janë marrë nga Enti Shtetëror Statistikor i RM-së, Shkup, 16.06.2009, Nr. 2.1.9.17.

<sup>5</sup> *Divorci dhe pasojat e tij*, artikulli gjendet në: <http://www.cdodite.com/20080425132058/Divorci-dhe-pasojat-e-tij.html>.

Viteve të fundit është paraqitur fenomeni i “shkurorëzimeve fiktive” të martesave, ku bashkëshortët përgënjeshtrojnë shkaqet për ndarje duke parashtruar arsye nga më të ndryshmet. Një nga arsyet më aktuale është gjendja e vështirë ekonomike dhe nevoja për të shkuar në botën perëndimore, andaj kjo edhe i shtyn shumë çifte (në të shumtën e rasteve gratë) të lejojnë ndarjen e martesës me qëllim që bashkëshorti, të jetë i lirë të lidhë martesë të re. E gjitha kjo ka për qëllim fitimin e shtetësisë në ndonjë shtet nga ku do të mund të sigurojë materialisht familjen e tij.

Praktika gjyqësore ka të shënuar një numër të konsiderueshëm të veprimeve konkrete të cilët paraqiten si shkaqe për çrregullimin e marrëdhënieve martesore: mosmarrëveshjet e vazhdueshme ndërmjet bashkëshortëve; dallimi i madh në moshë midis burrit dhe gruas; mosmarrëveshjet e njërit nga bashkëshortët me familjarët e bashkëshortit tjetër; dallimi në përkatësinë fetare midis partnerëve; dyshimet e vazhdueshme të xhelozisë; ofendimet e rënda të drejtuara ndaj njëri tjetrit; zënka të shpeshta dhe sulme fizike midis partnerëve; përdorimi i alkoolit nga njëri bashkëshort; impotenca gjegjësisht friggjediteti i plotë; mungesa e aftësisë së gruas për të lindur fëmijë; të jetuarit vetëm nga ana e njërit bashkëshort, si dhe shkaqe të tjera.<sup>6</sup>

Pra, bashkëshortët janë ata të cilët do të vendosin se cilin nga shkaqet do ta marrin si bazë për shkurorëzimin e tyre. Çdo rast i shkurorëzimit është i ndryshëm nga tjetri, duke u bazuar në problemet dhe karakterin e ndryshëm të personave, si dhe qasjen dhe mënyrën e të jetuarit në një bashkësi martesore. Mirëpo, të gjitha shkaqet që merren si arsye për ndarjen e një martese sjellin *jetën e padurueshme* të përbashkët. Këtë shkak e parasheh edhe Ligji mbi familjen i RM-së (neni 40 LF). Ndërkaq, jetën të padurueshme e bëjnë problemet e ndryshme që sjellin veprimet e njërit ose të dy bashkëshortëve, siç janë: xhelozia e pakontrolluar, kontradiktat dhe konfliktet gjatë çdo veprimi të njëri-tjetrit, keqpërdorimet dhe keqtrajtimet, dhuna fizike dhe psikike, shkelja e besnikërisë bashkëshortore,<sup>7</sup> shpenzimet tepër të mëdha që dëmtojnë pasurinë familjare, etj. Pra, Ligji mbi familjen i RM-së, shkaqe për të shkurorëzuar një martesë i kategorizon në tre grupe: pëlqimi i përbashkët i bashkëshortëve për ndarjen e tyre (neni 39.al.1 LF), nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë përkeqësuar deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme (neni 40 LF), dhe nëse marrëdhëniet martesore në mënyrë faktike kanë pushuar të funksionojnë më gjatë se një vit (neni 41 LF).

Sa i përket mosfunksionimit të martesës faktikisht, merren parasysh ato veprime të cilët vështirësojnë komunikimin dhe përmbushjen e detyrimeve familjare në mënyrë të përbashkët. Ndarja në aspektin hapësinor e bashkëshortëve me qëllim të nevojës për shkollim të mëtutjeshëm, specializim në profesionin e ndonjërit nga ta, por për të cilën ata me

<sup>6</sup> Mimoza Bakievska, *Brakot kako institucija vo Republika Makedonija*, Manastir 2007, fq. 44.

<sup>7</sup> Besnikëria është një përkushtim i ndërsjelltë, fizik e shpirtëror, i njërit bashkëshort ndaj tjetrit dhe ndaj familjes që kanë krijuar, një sinqeritet i gjithanshëm midis tyre që shtrihet mbi bashkëjetesën, mbi administrimin e procesit të plotësimit që nevojave të fëmijëve e të familjes dhe mbi çdo gjë tjetër që u përket martesës, familjes dhe vetë bashkëshortëve. Pra, besnikëria përputhet me “harmoninë e brendshme të bashkëshortëve” dhe, në mënyrë të përgjithshme, me “stabilitetin e bërthamës familjare, si dhe të interesit të fëmijëve”- Arta Mandro-Bilalli, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Arjana Fullani, *E drejta familjare*, Tiranë, 2006, fq. 238-239.



marrëveshje janë përcaktuar- nuk mund të llogaritet si pushim faktik i marrëdhënieve bashkëshortore. Në këto situata bashkësia martesore nuk pushon së funksionuari, ndërkaq bashkëshortët vazhdojnë të plotësojnë të drejtat dhe obligimet e tyre të cilat dalin nga martesa.<sup>8</sup> Përkundër kësaj, në rastet kur bashkëshortët nuk e ndryshojnë lokacionin e banimit të tyre, pra jetojnë në të njëjtën banesë, nën të njëjtin “pullaz”, ndërkaq nuk komunikojnë dhe nuk i përbushin të drejtat dhe detyrimet të cilat janë pjesë e institucionit të martesës- në këtë rast bëhet fjalë për të ashtuquajtura “martesa të vdekura” tek të cilat situata ka ardhur deri te ndërprerja faktike e bashkësisë martesore.<sup>9</sup>

Të dhënat e shumta japin rezultatin se në shtetin tonë në një përqindje të konsiderueshme ndahen martesat e reja (nga 1-3 vjet bashkëjetesë). Të rinjtë të cilët lidhin martesa në kohën e sotme për dallim nga më herët, më tepër i japin rëndësi të jetuarit në mënyrë bashkëkohore, barazisë midis partnerëve në martesë, nuk respektojnë kultin e autoritetit ndaj më të vjetërve, duke marrë qëndrime të ndryshme nga prindërit e tyre.<sup>10</sup>

Pra, çdo disekuilibrim i veprimeve që ndikon negativisht në jetën e përbashkët familjare mund të jetë shkak që martesa të ndahet, të cilin si arsyetim nga ana e bashkëshortëve gjykata e merr për bazë. Kur bashkësia martesore gjendet në një fazë kritike e cila mund të rezultojë në ndarje, është e nevojshme dhe e dobishme që bashkëshortët paraprakisht të drejtohen në Qendrën për punë sociale, respektivisht në sektorin për këshillime familjare (bashkëshortore) ose të shfrytëzojnë shërbimin e mediatorëve. Ndërkaq, në situatat kur ekziston konflikti midis bashkëshortëve, shërbimet juridike, veçanërisht Oda e Avokatëve duhet të ketë listën e avokatëve të cilët do të ofronin këshilla dhe shërbime profesionale në sferën e shkurorëzimeve dhe veçanërisht këto shërbime të jepen falas për çiftet të cilët nuk kanë mundësi materiale për t’i paguar.

Dhënia e ndihmës juridike pa pagesë për personat me probleme sociale është pjesë e obligimit tradicional dhe ndershmërisë së avokatit,<sup>11</sup> andaj këshillat e tilla duhet të ofrohen nga ana e çdo avokati kur pala i drejtohet për ndihmë juridike. Bazuar në *Kodeksin për etikën profesionale të avokatëve*, qysh prej marrjes së lëndës avokati duhet ta informojë palën në lidhje me shumën e shpenzimeve dhe lartësinë e shpërblimit për përfaqësimin, gjegjësisht kryerjen e autorizimeve publike. Kur bëhet fjalë për palë me gjendje të dobët materiale, përlllogaritjen e vet avokati duhet ta përshtatë me mundësitë materiale për të bërë pagesën, gjegjësisht, shpërblimin ta llogarisë edhe nën shumën minimalen për punë të avokatëve. Ndërkaq prej palëve kryesisht të varfra të mos kërkoj fare kompensim, duke marrë parasysh vazhdimisht parimin e vjetër etik të avokatëve: ‘në pamundësi për pagesë të shpërblimit të avokatit, askush të mos ngelë pa ndihmë juridike kualitative nga avokati.’<sup>12</sup>

<sup>8</sup> Liljana Spiroviq, *Semejno Pravo*, Shkup, 2004, fq. 133-134.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Mimoza Bakievska, *Prestanok na brakot so razvod vo Bitola*, Manastir, 2007, fq. 9.

<sup>11</sup> *Indeksi mbi reformën e profesioni ligjorë*, gjendet edhe në: [www.albanet.org/rol/publications/kosovo\\_lpri\\_04\\_2007\\_alb.pdf](http://www.albanet.org/rol/publications/kosovo_lpri_04_2007_alb.pdf).

<sup>12</sup> Pika 8 e Kodeksit për etikën profesionale të avokatëve, bashkëpunëtorëve profesional të avokatëve dhe praktikantëve të Dhomës së avokatëve të Republikës së Maqedonisë.

#### 4. Ndhimja Juridike pa Pagesë në Republikën e Maqedonisë

Kushtetuta e RM-së proklamon barazinë e të gjithë qytetarëve në liri dhe të drejta, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja kombëtare dhe sociale, bindja politike dhe fetare, pozita pasurore dhe shoqërore (neni 9 i Kushtetutës së RM-së). Ky parim kushtetues mundëson që të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë të kenë qasje tek institucionet e sistemit shtetëror. Për qytetarët parimi i mundësive të barabarta nuk do të thotë vetëm garantimi i të drejtave në sferën e të drejtës materiale, por ata duhet të jenë në pozitë të tillë që t'i njohin të drejtat e veta dhe të mund t'i realizojnë ato.<sup>13</sup> Ndhimja juridike pa pagesë, palës e cila dëshmon gjendjen e vështirë ekonomike, i garantohet edhe me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore- neni 6.al 3 pika c ('të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore pa pagesë kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë').

Sikurse në procedurat tjera kontestimore edhe në procedurën për zgjedhjen e kontesteve martesore, pala e cila do të dëshmojë gjendjen e vështirë materiale, lirohet nga pagesa e shpenzimeve procedurale. Ligji mbi procedurën kontestimore parasheh dispozita ligjore se nga cilat shpenzime procedurale lirohet pala (neni 163-169 i Ligjit mbi procedurën kontestimore, Gazeta zyrtare e RM-së nr.79/05). Ato shpenzime procedurale përfshijnë: lirimin nga pagimi i taksave dhe lirimi nga ofrimi i paradhënies së shpenzimeve për dëshmitarët, ekspertët, për shikimin dhe për shpalljet gjyqësore (al.2 neni 163,i LPK). Taksa gjyqësore në kontestet për shkurorëzimin e martesës është 60.000 denarë (neni 2 i Ligjit mbi ndryshimin e ligjit për taksat gjyqësore, Gazeta zyrtare e RM-së nr.20/1995). Kjo vlerë, krahasuar me nivelin ekonomik në shtetin tonë, paraqet një ngarkesë materiale dhe pamundëson shumicën që të iniciojnë procedurën e shkurorëzimit, veçanërisht personat me të ardhura të ulëta ose pa fare të hyra, pra, personat e regjistruar në entin për mbrojtje sociale të cilët marrin ndihma sociale ose personat të cilët edhe nuk i shfrytëzojnë këto ndihma.

Kur pala plotësisht është e liruar nga pagimi i shpenzimeve të procedurës, gjykata e shkallës së parë me kërkesë të saj do të caktojë ta përfaqësojë i autorizuari (përfaqësuesi), nëse një veprim i tillë është i domosdoshëm për shkak të mbrojtjes të së drejtave të palës. Pala të cilës i është caktuar autorizues lirohet nga pagimi i shpenzimeve dhe shpërblimi i autorizuesit të caktuar (al1.2 neni 165 LPK). Bazuar në *Tarifën për shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatit*, avokati është i obliguar të jep ndihmën juridike pa pagesë palës e cila sipas ligjit mund të jetë e liruar nga pagimi i shpenzimeve të procedurës ( e drejta varfanjake)- neni 6.<sup>14</sup> Palët që kanë dëshmuar gjendjen e tyre të vështirë ekonomike janë liruar nga pagesa e taksave gjyqësore, mirëpo nuk ka të dhëna zyrtare lidhur me përfaqësimin profesional pa pagesë në procedurën e shkurorëzimit.

Edhe përkundër ekzistimit të dispozitave të këtilla, situata në praktikë qëndron ndryshe, palët që dëshmojnë gjendjen e tyre të vështirë ekonomike lirohen nga pagimi i taksave gjyqësore

<sup>13</sup> Propozim Ligji për ndihmën juridike pa pagesë, Janar 2009, fq. 3.

<sup>14</sup> Tarifa për shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatit, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.153/2008.

por ata paguajnë shpenzime lidhur me përfaqësimin e tyre në procedurën gjyqësore, ndërkaq një ndër qëllimet kryesore të këtij institucioni është që personi të mund të përfitojë të drejtën në përfaqësim ligjor në procedurën e shkurorëzimit. Andaj, për shkak të moszbatimit të këtyre dispozitave ligjore me arsyetimin se gjykatat nuk kanë mjete financiare të mjaftueshme, dhe për shkak të nevojës për përfshirje më të gjerë të këtij institucioni (ndihmës juridike pa pagesë) është vlerësuar se dispozitat e Ligjit mbi procedurën kontestimore të cilat kanë të bëjnë me lirim nga shpenzimet procedurale, nuk sigurojnë në mënyrë të mjaftueshme të drejtën e garantuar me kushtetutë.<sup>15</sup>

Në RM ndihma juridike pa pagesë është institucion juridik i ri, i cili do të fillojë të zbatohet me miratimin e Ligjit mbi ndihmën juridike pa pagesë. Fushata propaganduese rreth realizimit të kësaj të drejte duhet të organizohet nga ana e Qeverisë së RM-së në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë. Këto organe duhet të përgatitin udhëzime për informimin e qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre dhe mjetet juridike. Personat që kanë probleme në martesë, dhe që kanë vendosur të bëjnë ndarjen e saj me anë të shkurorëzimit, ndërkaq nuk kanë mjete për ta iniciuar dhe zhvilluar procedurën gjyqësore duhet të dinë se: Cila kategori e personave mund të realizojë këtë të drejtë, kur mund ta realizojë, si mund ta realizojë, ku mund të drejtohet, dhe kush mund të ofrojë këtë lloj të ndihmës juridike.

Rol të rëndësishëm, madje edhe parësor lidhur me implementimin efikas të këtij institucioni ka edhe Oda e Avokatëve të RM-së, e cila duhet të përgatisë listën e avokatëve të cilët do të ofrojnë përfaqësime pa pagesë në procedurën e shkurorëzimit. Andaj pala e cila është kërkuese e kësaj ndihme, duhet së pari të këshillohet se si dhe ku ta drejtojë kërkesën e vet, ndërkaq, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës të këshillohet me përfaqësuesin që do t'i caktohet. Para inicimit të procedurës, gjithsesi duhet të ketë zyrë konkrete ku mund të drejtohen të gjithë qytetarët për të marrë informata të detajuara. Informata dhe këshilla juridike për realizimin e ndihmës juridike mund të japin edhe fakultetet juridike të cilët kanë organizuar klinika juridike, veçanërisht programe për klinikat për ndihmë juridike në çështjet dhe kontestet familjare, projekte këta të mbikëqyrura nga profesionistë. Përfaqësime në gjyq mund të ofrojnë vetëm subjektet profesionale siç janë avokatët të cilët kanë përvojë profesionale për përfaqësimin e palëve në procedurën e shkurorëzimit bazuar në legjislacionin familjar shtetëror dhe ndërkombëtar.

Kërkesën për ndihmën juridike pa pagesë e paraqet personalisht pala kërkuese deri tek sektori rajonal i Ministrisë së Drejtësisë. Kërkesa mund të paraqitet edhe nëpërmjet postës duke plotësuar formularin e caktuar nga Ministri (neni 19 al.1 i Propozim Ligji për ndihmën juridike pa pagesë). Subjektet që duhet të ofrojnë këtë shërbim, sipas propozim-ligjit për ndihmën juridike pa pagesë janë: shoqata të qytetarëve<sup>16</sup> (japin ndihmën juridike

<sup>15</sup> Propozim Ligji për ndihmën juridike pa pagesë, Janar 2009, fq. 2.

<sup>16</sup> Janë shoqata të autorizuara të qytetarëve të regjistruara në regjistrin e shoqatave të qytetarëve për ndihmë juridike; duhet të kenë të punësuar së paku një (1) jurist të diplomuar i cili ka të dhënë provimin e jurisprudencës; të kenë të siguruar hapësirë e cila përmban kushtet minimale teknike për ushtrimin e veprimtarisë; gjatë këshillimit, të kenë lidhur kontratën për sigurimin e përgjegjësisë për dëmin eventual deri në lartësinë e polisës më të ulët/ shumë të sigurimit. (neni 17 i Propozim Ligji për ndihmën juridike pa pagesë).



paraprake)<sup>17</sup>, avokatët për ndihmën juridike të regjistruar në regjistrin pranë Ministrisë së Drejtësisë, dhe mediatorët të cilët gjithashtu janë të regjistruar si subjekt për ofrimin e ndihmës juridike pa pagesë. Një kopje nga regjistri i avokatëve Ministria e drejtësisë duhet t'ja dërgojë Odës së Avokatëve, ndërkaq një kopje nga regjistri i mediatorëve ja dërgon Odës së Mediatorëve (neni 27 al.2 i Propozim ligji për ndihmën juridike pa pagesë).

Pra, Ministria e Drejtësisë nga fillimi i vitit 2010 do të miratojë shfrytëzimin e ndihmës juridike pa pagesë në pajtim me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në bazë të ligjit të veçantë, i cili do të hyjë së shpejti në procedurën e Qeverisë. 'Qëllimi i ligjit është që të sigurohet qasje e barabartë e qytetarëve deri tek institucionet për njohjen, realizimin dhe mundësimin e ndihmës efektive juridike në pajtim me parimet për qasje të barabartë deri në drejtësi', ka potencuar në një konferencë për shtyp zëvendës-ministri i Drejtësisë, duke e prezantuar propozim ligjin për ndihmë juridike falas. Që të marrin ndihmë juridike pa pagesë gjendja e pronës së personave të cilëve iu nevojitet kjo ndihmë nuk duhet të tejkalojë vlerën prej pesë bruto rrogave mesatare në muajin paraprak, d.m.th vlera e pasurisë mos të arrijë ose tejkalojë vlerën prej 147.930 dinarë ose 2.405 euro.<sup>18</sup> Ata persona duhet të jenë pjesë e shfrytëzuesve të ndihmës sociale, me të drejtë të shtesës invalide të cilët nuk realizojnë të ardhura të tjera, të pensionit më të ulët të cilët jetojnë në bashkësi familjare me dy apo më shumë persona të mbajtur nga dikush, si dhe familje apo prind tutor me një apo më shumë fëmijë adoleshent, të cilët kanë të drejtë për shtesa fëmimore, persona të zhvendosur. Ndihmja juridike pa pagesë, do të realizohet si ndihma juridike paraprake dhe ndihma juridike në të gjitha procedurat gjyqësore. Ndihmën juridike paraprake do ta japin persona zyrtarë në sektorët rajonale të Ministrisë së Drejtësisë dhe shoqatave të autorizuara të qytetarëve, ndërsa në pjesën tjetër të procedurave gjyqësore atë do ta realizojnë avokatë dhe mediatorë. Me ndihmën e këtillë juridike do të përfshihen shpenzimet e procedurës të cilat kanë ndodhur pas ditës së miratimit të kërkesës për ndarjen e saj.<sup>19</sup>

Shërbimet juridike pa pagesë për zgjidhjen e martesës me shkurorezim në të shumtën e rasteve jepen nga ana e organizatave joqeveritare të cilët promovojnë dhënien e ndihmës juridike falas në formë të këshillimeve nëpërmjet telefonit, postës elektronike, lirim nga taksat gjyqësore për femrat të cilat nuk kanë sigurim social dhe ato që nuk kanë mundësi ekonomike dhe në raste shumë të rralla edhe përfaqësime në gjyq nga ana e avokatëve të angazhuar nga OJQ. Pala personalisht plotëson kërkesën për ndihmën juridike pa pagesë.<sup>20</sup>

<sup>17</sup> Ndihmja juridike paraprake nënkupton: këshilla juridike për shfrytëzimin e të drejtës në ndihmë juridike; informata të përgjithshme juridike; ndihma juridike në përpilimin e kërkesave drejtuar organeve administrative. (neni 6 al.1.parag.1 i Propozim ligji për ndihmën juridike pa pagesë).

<sup>18</sup> Shiko në: [http://www.investko.com/index.php?option=com\\_content&view=article&id=27:2009-04-02-07-52-36&catid=10:0409-&Itemid=19](http://www.investko.com/index.php?option=com_content&view=article&id=27:2009-04-02-07-52-36&catid=10:0409-&Itemid=19).

<sup>19</sup> Lajmi është publikuar në MIA Agjencia informative e Maqedonisë, më 7 gusht 2009, <http://www.mia.com.mk/default.aspx?mId=32&vId=66684562&lId=3&title=MAQEDONI+-+JURISPRUDENC%3c3%8b>.

<sup>20</sup> Paraqes një formë të formularit që e shfrytëzon Qendra për të drejtat e grave-Shelter Centre-Në formular shënohen të dhënat personale të kërkuarit të ndihmës juridike (emrin dhe mbiemrin, adresën, numrin e amzës, telefonin për kontakt), pala duhet të përgjigjet me Po ose Jo në pyetjen se a pajtohen që QMDF të marr përsipër veprime në emrin saj, si p.sh. shikimi i lëndës nga ana e organit kompetent, dorëzimi i dokumenteve në organet/institucionet përkatëse, kontakt me avokatin e saj (nëse e ka) etj; si dhe nënshkrimin e palës. Në fund të kërkesës qëndron klauzola: QMDF deklaron se të gjitha të dhënat lidhur me çështjen e palës do të jenë sekrete.

Zakonisht, këto organizata promovojnë ofrimin e këtyre shërbimeve në rastet kur pala ju drejtohet me problemet e tyre familjare për shkak të dhunës fizike dhe psikike të ushtruar nga partneri. Në të shumtën e rasteve (gati se në të gjitha rastet) viktima të dhunës familjare janë gratë. Për shkak të mos-qasjes deri tek mjetet e informimit, një numër i konsiderueshëm i grave në vendet rurale nuk njohin mundësinë e paraqitjes së rastit të dhunës deri tek organet kompetente, e aq më pak mundësinë e dhënies fund të bashkësisë martesore me anë të shkurorëzimit. Duhet përmendur këtu aktivitetet e Organizatave joqeveritare, veçanërisht organizatave të cilat mbrojnë dinjitetin e gruas dhe rolin e saj në familje dhe shoqëri. Këto organizata kanë rëndësinë e tyre të caktuar në dhënien e shërbimeve juridike dhe sociale. Ata zhvillojnë strategjinë e mbrojtjes të gruas në të gjitha sferat e jetës si në shoqëri dhe familje, andaj edhe zhvillojnë projekte të ndryshme në vendet urbane dhe rurale duke i informuar gratë se ku të drejtohen dhe si të veprojnë në situatat kur ju shkelet e drejta e garantuar. Ndihmë juridike pa pagesë në formën e informimit të qytetarëve për të drejtat e tyre ofron edhe Shoqata e juristëve të rinj e Maqedonisë nëpërmjet linjës së hapur telefonike e cila është falas.<sup>21</sup>

Në RM të dhënat rreth procedurës së shkurorëzimit mund të merret vetëm nga organet shtetërore, nga avokati dhe mediatorët. Fatkeqësisht mungojnë burime tjera të informimit. Në vendet evropiane e sidomos në SHBA ekzistojnë burime të ndryshme të cilët ua lehtësojnë qytetarëve qasjen deri tek informacionet e nevojshme për shkurorëzimin e martesës, duke filluar nga burimet elektronike (gjetja e avokatëve që realizojnë shkurorëzimin, mediatorëve, informata rreth alimentacionit, legjislacionin ku përfshihen të drejtat dhe obligimet për bashkëshortët që shkurorëzohen si dhe rrjedhja e procedurës, forma dhe përmbajtja e kontratës apo marrëveshjes për shkurorëzim, të dhënat për përgatitjen dhe paraqitjen në gjykatë, organizimi i forumeve ku mund të parashtrihen pyetje përgjigjet e të cilëve i japin profesionistët në fushën e shkurorëzimeve, të drejtat e fëmijëve prindërit e të cilëve shkurorëzohen, informata për gjyshërit lidhur me të drejtat e tyre ndaj nipërve, dhe shumë të dhëna të detajuara të nevojshme për bashkëshortët). Vendosja e këtyre kontakteve u mundëson palëve një përkrahje juridike dhe psiko-sociale.

Duke marrë parasysh nivelin edukativo-arsimor të popullatës sonë, informimi rreth këtij institucioni duhet të bëhet në mënyrën më të qartë dhe të thjeshtësuar, jo të ngarkuar me formalizma. Shpërndarja e broshurave me udhëzime për shfrytëzimin e kësaj ndihme juridike në rastet e problemeve bashkëshortore dhe familjare, mund të ndërmerret si hap i parë.

### **5. Pasojat Juridike të Shkurorëzimit tek Bashkëshortët dhe Fëmijët**

Bashkëshortët janë ata të cilët duhet të mbartin pasojat e përfundimit të martesës së tyre me anë të shkurorëzimit, duke mos lejuar që ata të njëjtat të reflektohen tek fëmijët. Mirëpo, juridikisht një gjë e tillë nuk është e mundur. Fëmijët ndikohen nga kjo ndarje, nga vetë fakti që ata janë të detyruar të jetojnë me njërin prind. Shkurorëzimi, ndaj bashkëshortëve ka

<sup>21</sup> Qytetarët e interesuar mund të lajmërohen në kontakt telefonin falas: 0800 44 222.

pasoja lidhur me: mbiemrin, trashëgiminë, ndarjen e pasurisë së përbashkët<sup>22</sup>, alimentacionin (ndarjen e ushqimit bashkëshortit të pasiguar materialisht), çështjen e banimit, pagimit të shpenzimeve procedurale, çështja e dëmshpërblimit të ndonjë dëmi eventual, etj. Kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, atëherë personeli profesional i Qendrës për punë sociale udhëheq procedurën për pajtimin e bashkëshortëve. Nëse seanca për pajtimin e bashkëshortëve është e pasuksesshme atëherë ekipi profesional i Qendrës për punë sociale jep mendimin dhe propozimin për ruajtjen, edukimin e fëmijëve, dhe bazuar në faktet dhe të dhënat profesionale, gjykata në seancën kryesore vendos edhe për edukimin, ushqimin dhe ruajtjen e fëmijëve.

Bashkëshortët mundet që me marrëveshje të përbashkët të zgjidhin çështjen e ndarjes së fëmijëve. Nëse nuk ekziston marrëveshja midis tyre lidhur me përkujdesjen e fëmijëve atëherë, gjykata *ex officio* sjell vendimin për ruajtjen, edukimin dhe ushqimin e fëmijëve. Andaj fëmijët mund të vazhdojnë jetën e mëtutjeshme me njërin prind, ose nëse janë dy ose më tepër fëmijë – disa me njërin e disa me tjetrin prind, ndërkaq nëse ruajtja dhe edukimi i fëmijëve nga prindërit e tyre është në kundërshtim me interesin e tyre, atëherë fëmijët ngelin nën përkujdesjen e organit të kujdestarisë.

Edhe pse fëmijët i ndahen njërit prind, me anë të shkurorëzimit nuk mund të ndërpritet marrëdhënia prindërore, ajo marrëdhënie familjare midis fëmijëve dhe prindërve ekziston edhe pas ndarjes. Çiftet të cilët kanë fëmijë dhe të cilët kanë vendosur të jetojnë të ndarë, duhet të vazhdojnë të sjellin vendime të përbashkëta sa i përket mirërritjes dhe edukatës familjare të fëmijës. Shkurorëzimi në të shumtën e rasteve nuk ndikon negativisht tek fëmijët që jetojnë ndaras nga njëri prind, në krahasim me mosmarrëveshjen dhe grindjet e vazhdueshme që mund të kenë çiftet. Edhe pse të ndarë nga fëmijët, çiftet vazhdojnë të jenë prindërit e tyre përkundër mos-koordinimeve që kanë ndërmjet vete për çështje tjera jetësore, mirëpo, në çdo vendimmarrje të tyre në prioritet duhet të kenë interesin më lartë të fëmijëve. Pasojat personale të shkurorëzimit duhet të ndikojnë drejtpërdrejtë tek ish-bashkëshortët, e assesi tek fëmijët, sepse ata nuk janë aspak fajtorë për situatën jetësore që ua krijojnë prindërit.

Edhe pse shkurorëzimi është alternativa më e dhimbshme për fëmijët, mirëpo në situata të veçanta paraqet zgjedhje të vetme në një martesë ku mbisundon grindja e jo marrëveshja, dashuria dhe respekti. Fëmijët të cilët kalojnë nëpër fazën e ndarjes së prindërve, duhet të jenë të bindur se ata vazhdojnë të kenë dashurinë prindërore dhe se një ndarje e tillë bëhet për jetë më të qetë të cilën prindërit në bashkësi martesore nuk kanë mundur tua ofrojnë. Në disa nga rastet fëmijët janë motivimi dhe arsyeja e vetme për t'i mbyllur sytë ndaj mosmarrëveshjeve. Disa çifte sakrifikojnë “lumturinë” e tyre dhe vazhdojnë të bashkëjetojnë në mungesë të dashurisë së ndërsjellët. E gjithë kjo sakrificë bëhet duke patur synim kryesor lumturinë e fëmijëve të tyre dhe duke mos i sprovuar me pjesën më të dhimbshme - ndarjen nga ata.

<sup>22</sup> Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve e fituar gjatë martesës, nuk ndahet në procedurën e shkurorëzimit, por zhvillohet procedurë e veçantë, kontestimore- nëse ekziston mosmarrëveshja (kontesti) për ndarjen e saj, dhe jokontestimore - nëse bashkëshortët janë marrë vesh si do ta ndajnë atë pasuri të fituar bashkërisht.

## 6. Përfundimi

Rëndësia e ndihmës juridike falas është e padiskutueshme, mirëpo paraprakisht duhet të përgatiten kushtet për aplikimin e saj nga ana organeve shtetërore. Ndihmja juridike pa pagesë në RM do të ketë vështirësitë e implementimit të saj, edhe atë për arsye të ndryshme. Jam e mendimit nga ana e organeve shtetërore ende nuk janë krijuar kushtet për zbatimin efikas të këtij institucioni të rëndësishëm për popullatën tonë me një nivel kaq të ulët socio-ekonomik. Përkundrazi, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike me të cilën përballen shumë familje, ky mekanizëm është më se i nevojshëm. Keqpërdorimi i tij është i mundshëm, pasi ekziston rreziku që kjo ndihmë juridike t’ju ofrohet personave të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore por falsifikojnë dokumentet e nevojshme për ndarjen e kësaj ndihme.<sup>23</sup> Andaj Ministria e Drejtësisë, si organ kompetent për aprovimin e kërkesës duhet të garantojë paanshmëri dhe respektim absolut të kësaj të drejte ligjore ndaj personave të cilëve për shkak të vështirësive financiare u cenohet e drejta e qasjes ndaj organeve të drejtësisë.

Pritet që ky institucion më tepër të shfrytëzohet nga pjesa e shoqërisë e cila ka një arsimim të mesëm ose të lartë. Kjo për arsye se ata do të jenë në gjendje të dinë së si të informohen dhe ku të drejtohen. Ndërkaq, për pjesën tjetër të shoqërisë do të kisha potencuar çështjen e ndikimit të mentalitetit. Gjenerata më e vjetër ende janë të veshur me petkun e durimit dhe ‘ruajtjen’ e dinjitetit familjar. Ata nuk mund të arsyetojnë ndarjen edhe përkundër mosmarrëveshjeve dhe grindjeve të vazhdueshme. Durimi dhe shpresa për një jetë më të mirë bashkëshortore i bën të varur nga partneri tjetër. Këtu rol shumë të rëndësishëm luan edhe varshmëria materiale, veçanërisht e gruas ndaj burrit si dhe niveli i ulët i qasjes tek mbrojtja ligjore e të drejtave të tyre.

Në fund duhet theksuar rëndësia e institucionit të shkukurorëzimit, shikuar në prizmin e shërimit të problemeve familjare. Edhe pse nuk pajtohem që familja e themeluar të ndahet, e veçanërisht nëse në atë familje ka fëmijë, jam i thartë e mendimit që nuk duhen duruar veprime të cilat sjellin cënimin e një jete të shëndoshë familjare. Edhe pse fëmijët në fillim mund të zhgënjehen nga prindërit e tyre dhe të humbin shpresat për një jetë të lumtur familjare, kur vetëdijesohen ata mund të arsyetojnë veprimin e tyre. Mirëpo, interesi i fëmijëve duhet të jetë një prioritet përkundër interesit personal të ish-bashkëshortëve.

<sup>23</sup> Sipas Propozim ligjit për ndihmën juridike pa pagesë- nëse vërtetohet se parashtruesi i kërkesës për shfrytëzimin e ndihmës juridike pa pagesë, me qëllim që ti ndahet kjo ndihmë ka paraqitur të dhëna jo të sakta, në këtë rast me anë të vendimit nuk do ti lejohet shfrytëzimi i kësaj të drejte, dhe humb të drejtën që të parashtrtoj kërkesë të re në afatin brenda gjashtë (6) muajve nga dita e sjelljes së vendimit. Nëse gjatë kohës së shfrytëzimit të së drejtës për ndihmë juridike, vërtetohet se shfrytëzuesi ka paraqitur të dhëna jo të sakta me qëllim që të realizoj të drejtën në ndihmë juridike pa pagesë, Ministria me vendim do të ndërpres shfrytëzimin e mëtutjeshëm të kësaj të drejte dhe në afat prej tetë (8) ditëve do të kërkoj kthimin e mjeteve të paguara. Nëse brenda afatit të caktuar, pala nuk do ti kthej mjetet, Ministria e drejtësisë do të iniciojë procedurë para gjykatës kompetente për kthimin e mjeteve të paguara (neni 25, al.3,4).

## BIBLIOGRAFIA

- Bakievska, M. *Prestanok na brakot so razvod vo Bitola*, Manastir, 2007
- Bakievska, M. *Brakot kako institucija vo Republika Makedonija*, Manastir 2007
- Mandro-Bilalli, A.; Meçaj, V.; Zaka, T.; Fullani, A., *E drejta familjare*, Tiranë, 2006
- Oruçi, G. *E drejta familjare*. Prishtinë, 1994
- Spiroviq, L., *Semejno Pravo*, Shkup, 2004
- Kodeksi për etikën profesionale të avokatëve, bashkëpunëtorëve profesional të avokatëve dhe praktikantëve të Dhomës së avokatëve të Republikës së Maqedonisë
- Kushtetuta e RM-së, 1991
- Ligji mbi familjen (teksti i spastruar), Gazeta zyrtare e RM-së nr.157 /2008
- Ligjit mbi procedurën kontestimore, Gazeta zyrtare e RM-së nr.79/2005
- Ligjit mbi ndryshimin e ligjit për taksat gjyqësore, Gazeta zyrtare e RM-së nr.20/1995
- Propozim Ligji për ndihmën juridike pa pagesë, Janar 2009,
- Tarifa për shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatit, Gazeta zyrtare e RM-së, nr.153/2008
- The European Convention on Human Rights and fundamental freedoms, 1950
- Universal Declaration of Human Rights, 1948
- *A Few Words About Divorce*, gjendet në: <http://diggerjones.wordpress.com/2006/12/06/a-few-words-about-divorce>
- *Divorci dhe pasojat e tij*, artikulli gjendet në: <http://www.cdodite.com/20080425132058/Divorci-dhe-pasojat-e-tij.html>
- Indeksi mbi reformën e profesioni ligjor, gjendet në: [www.albanet.org/rol/publications/kosovo\\_lpri\\_04\\_2007\\_alb.pdf](http://www.albanet.org/rol/publications/kosovo_lpri_04_2007_alb.pdf)